




Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
Regulatorna Komisija Javne Nabavke
Public Procurement Regulatory Commission



KOMISIONI RREGULLATIV PËR PROKURIMIN PUBLIK

Në bazë të nenit 87, paragrafit 2, nënparagrafit 2.4, nenit 25 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe në bazë të nenit 13 të Rregullores së punës së KRPP-së, nxjerrë:

RREGULLORE

NR. 2/2017

PËR PROCEDURAT E DHËNIES DHE REVOKIMIT TË CERTIFIKATËS PROFESIONALE PËR PROKURIMIN PUBLIK

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të hollësishme për procedurat e dhënies dhe revokimit të certifikatave themelore profesionale të prokurimit dhe certifikatave të avancuara profesionale të prokurimit.

Me këtë rregullore përcaktohen rregullat për dhënie të certifikatave, klasifikimi i shkeljeve të Ligjit të Prokurimit Publik, procedurat e emërimit dhe kompetencat e komisionit, trajtimi i kërkesave, masat ndëshkuese, të drejtat dhe përgjegjësitë e palëve në proces - pala e cila ka iniciuar kërkesën dhe pala e cila është atakuar me revokimin.

Neni 2 Përkufizimet

Termat dhe shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin e paraparë në nenin 4 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Neni 3

Procedura për dhënie të certifikatave

1. Certifikata profesionale e prokurimit publik lëshohet në përputhje me nenin 25 të LPP.
2. Në rast se një person posedon një certifikatë ose diplomë të avancuar të nivelit bachelor ose master të prokurimit të njohur ndërkombëtarisht, personi në fjalë është i përjashtuar nga obligimi për certifikim.

3. Certifikatë e avancuar konsiderohet:
- ✓ një certifikatë e avancuar, e fituar nga një institucion i licencuar arsimor;
 - ✓ nëse programi arsimor është i bazuar në Direktivat e Prokurimit të KE, si dhe në praktikat më të mira ndërkombëtare;
 - ✓ të ketë zgjatur minimum pesëmbëdhjetë (15) ditë,
 - ✓ kandidati t'i jetë nënshtruar provimit dhe me sukses ta ketë përfunduar atë.
4. Diplomë e avancuar konsiderohet:
- ✓ një diplomë e cila është fituar në një institucion të licencuar arsimor brenda apo jashtë Kosovës, dhe që i përket drejtimit të prokurimit publik.
5. Vlefshmëria e certifikatës e përcakton KRPP, pas kërkesës me shkrim dhe dokumentimit të plotësimit të të gjitha kushteve të përcaktara në paragrafin 3 të këtij neni, nga personi në fjalë.
6. Vlefshmëria e diplomës e përcakton KRPP, pas kërkesës me shkrim dhe nostrifikimit të diplomës nga Ministria e Arsimit të Republikës së Kosovës.

REVOKIMI I CERTIFIKATAVE

Neni 4

Klasifikimi i shkeljeve të ligjit

Shkeljet e ligjit ose rregullave të prokurimit, ndahen në:

1.1 Shkelje të lehta; dhe

1.2 shkelje të rënda.

Neni 5

Shkeljet e lehta

Shkeljet e lehta konsiderohen:

1. Neglizhimi i afateve kohore lidhur me ofrimin e sqarimeve shtesë të kërkuara nga Operatorët Ekonomik;
2. Neglizhimi i afateve kohore për vlerësimin e tenderëve të përcaktuara në nenin 41 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik; Humbja e çelësave, në rast se zyrtari i prokurimit është anëtar i komisionit të hapjes;
3. Mos adresimi i rekomandimeve të KRPP-së që rezultojnë nga procedura e monitorimit;
4. Mos dorëzimi i Deklaratës nën Betim për zyrtarët e Prokurimit në KRPP;
5. Vonesa në dorëzim të Planit Përfundimtar të Prokurimit publik në AQP;
6. Mos dorëzimi i Deklaratës së nevojave dhe Disponueshmërisë së mjeteve në AQP për aktivitetet e prokurimit të cilat nuk janë paraparë në Planin Final të Prokurimit;
7. Mos zbatimi i nenit 31.4 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik nga zyrtari përgjegjës i aktivitetit të prokurimit dhe si rrjedhojë skadimi i afateve kohore të vlefshmërisë dhe sigurisë së tenderëve.

Shkeljet e parapara në nenin 5 të kësaj rregulloreje nëse përsëriten, konsiderohen shkelje të rënda.

Neni 6

Shkeljet e rënda

1. Mashtrimi, kërcërimi, apo ushtrimi i çfarëdo presioni ose ndikimi të çfarëdo lloji në një zyrtar të prokurimit ose në një person tjetër të përfshirë në një aktivitet të prokurimit në mënyrë që zyrtari tjetër të kryej vlerësimin në kundërshtim me këtë ligj.
2. Falsifikimi, fshehja apo eliminimi i dokumenteve gjatë zhvillimit të një procedure të prokurimit;;
3. Mos lejimi dhe/ose neglizhimi i qasjes në dokumente zyrtare sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga pala e interesit kur një qasje e tillë e kërkuar është në përputhje me nenin 10 dhe 11 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Mos respektimi apo shkelja e parimeve themelore të prokurimit publik të përcaktuara me LPP kur zyrtari i prokurimit në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë vendos kritere apo dëshmi jo në përputhje me këtë ligj apo ia përshtatë ato një ofertuesi të caktuar, apo bënë trajtim jo të barabartë të ofertuesve gjatë ushtrimit të procedurave të prokurimit, përveç specifikimit teknik përgjegjësisë e të cilit bie nën Njësinë e kërkesës.

4. Mos respektimi i rregullave për trajtimin e kërkesave për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues.
5. Në çiftë se në periudhën brenda një viti i shqiptohen tri (3) vërejtje me shkrim nga KRPP.
6. Mos respektimi i vendimeve të OSHP-së dhe KRPP-së.
7. Mos dorëzimi i Planit Përfundimtar të Prokurimit publik në AQP;
8. Mos shfrytëzimi i kontratave të konkluduara nga prokurimet e centralizuara;
9. Mos respektimi i Udhëzimit Administrativ të Qeverisë së Kosovës për prokurimet e centralizuara;
10. Anulimi i aktiviteteve të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të Ligjit të Prokurimit Publik, apo kur ato anulohen në bazë një urdhëri të lëshuar nga ZKA i autoritetit kontraktues.
11. Nëse pas procesit të monitorimit, lëshohet një raport negativ nga monitorimi për devijime serioze procedurale nga Ligji i Prokurimit Publik të cilat janë dokumentuar.
12. Nëse kërkesat e përshtatshmërisë dhe/ose kushtet e kualifikimit të përcaktuara me nenin 23 të Ligjit të Prokurimit Publik nuk janë plotësuar, ose më nuk i plotëson.
13. Kontrata publike është nënshkruar gjatë periudhës së pritjes sipas nenit 26 të Ligjit të Prokurimit Publik apo gjatë periudhës së vënies së ndonjë mase të përkohshme të urdhëruar nga OSHP.
14. Për cilindo veprim të specifikuar në nenin 130 të Ligjit të Prokurimit Publik që faktikisht ka kryer apo është përfshirë zyrtari i prokurimit e që rezultojnë me ndjekje penale të një veprimi të tillë.
15. Nëse ka prova të mjaftueshme që dëshmojnë për sjellje të gabuar apo jo profesionale të një zyrtari të prokurimit ndaj operatori ekonomik apo ndaj cilindo personi gjatë ushtrimit të procedurave të prokurimit.

16. Anulimi i aktiviteteve të prokurimit si rrjedhojë e skadimit të afateve kohore të vlefshmërisë dhe sigurisë së tenderëve.

Neni 7

Inicimi i revokimit të certifikatës profesionale të prokurimit

1. Revokimi i certifikatës profesionale të prokurimit mund të iniciohet nga:
 - a) Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik;
 - b) Organi Shqyrtues i Prokurimit; dhe
 - c) Çdo autoritet kontraktues, kurdo që vëren shkelje të neneve të lartpërmendura.

Neni 8

Forma dhe përmbajtja e kërkesës

Kërkesa për revokimin e certifikatës profesionale të prokurimit, mund të parashtrohet në dy forma:

- a) Forma e kërkesës e parashtruar në kopje fizike; dhe
 - b) Forma e kërkesës e parashtruar në mënyrë elektronike.
- a) Forma e kërkesës e parashtruar në kopje fizike duhet të përmbajë: emrin e Autoritetit Kontraktues, emrin e parashtruesit të kërkesës dhe të Zyrtarit Kryesor Administrativ, datën dhe numrin e protokollit.
 - b) Kërkesa e parashtruar në formë elektronike duhet të përmbajë emrin e autoritetit kontraktues, emrin e parashtruesit të kërkesës dhe "CC" Zyrtari Kryesor Administrativ.

Neni 9

Themelimi i komisionit

1. Komisioni themelohet me vendim të Bordit të KRPP-së.
2. Komisioni përbëhet prej tre anëtarëve. 2 (dy) anëtar me mandat 3 vjeçar, ndërsa anëtari i 3 (tretë) zgjidhet në baza ad-hoc.

Neni 10

Kompetencat e komisionit

1. Komisioni ka këto kompetenca:
 - 1.1 Të dëgjoj provat lidhur me shkeljen e supozuar;
 - 1.2 Të vendos në bazë të provave, nëse është kryer shkelja; dhe
 - 1.3 Të propozoj masën që duhet shqiptuar, bordit të KRPP-së.

Neni 11

Masat disiplinore për shkelje të lehta

1. **Paralajmërimi me shkrim** shqiptohet në proporcion me pasojat e shkaktuara dhe ka për qëllim këshillimin dhe paralajmërimin e palës së atakuar për masat tjera më të rënda në rast të përsëritjes së shkeljes. Shqiptimi i kësaj mase bëhet brenda dhjetë (10) ditëve të punës nga data kur komisioni jep mendimin e vet. Paralajmërimi i shqiptuar i dërgohet Zyrtarit Kryesor Administrativ të AK. Ky paralajmërim fshihet brenda një viti nga dita e dhënies së tij.
2. **Vërejtja me shkrim** shqiptohet në proporcion me pasojat e shkaktuara dhe publikohet në ueb-faqen e KRPP-së. Shqiptimi i kësaj mase bëhet brenda dhjetë (10) ditëve të punës nga data kur komisioni jep mendimin e vet. Vërejtjet e shqiptuara fshihen brenda një viti nga dita e dhënies së tyre.

Neni 12

Masat disiplinore për shkelje të rënda

1. Për shkelje të rënda të dispozitave të Ligjit të Prokurimit Publik dhe legjisllacionit dytësor duke përfshirë edhe ato të specifikuar në nenin 6 të kësaj rregulloreje, bordi i KRPP-së duke u bazuar në propozimin e komisionit do të vendos për revokimin e certifikatës profesionale të prokurimit brenda dhjetë (10) ditëve të punës nga data kur komisioni ka dhënë propozimin e vet. Çdo revokim i certifikatës së prokurimit publik publikohet në ueb-faqen e KRPP-së.

Neni 13

Afati kohor për trajtimin e kërkesave

1. Kërkesa me shkrim dhe dokumentacioni i kompletuar, do të ekzaminohet dhe shqyrtohet nga komisioni brenda afatit prej 15 ditë pune nga data e vendimit të bordit të KRPP-së për emërimin e komisionit. Për rastet e ndërlikuara apo që nuk janë të përcaktuara me nenin 5 dhe 6 të kësaj rregulloreje komisioni do të ketë edhe një afat shtesë prej 5 ditë pune për të dhënë mendimin e vet.

Neni 14

E drejta e ankesës

1. Zyrtari i Prokurimit i pakënaqur me vendimin e Bordit të KRPP-së, ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e njoftimit për vendimin, nëse i njëjti është shërbyes civil.
2. Nëse Zyrtari i Prokurimit nuk është shërbyes civil, ka të drejtë ankese sipas Ligjit për Procedurën Administrative. Nëse pas përfundimit të procedurës së ankesës sipas Ligjit për Procedurën Administrative personi në fjalë është i pa kënaqur me rezultatin, atëherë ai/ajo mund të ankohet për anulimin e certifikatës në Gjykatën Themelore – Departamenti për çështje administrative.
3. Personit të cilit i është anuluar certifikata profesionale e prokurimit, pas një viti mund të fillojë trajnimin bazik për tu pajisur me një certifikatë themelore profesionale të prokurimit dhe pas kësaj, të ndjek trajnimin për t'u pajisur me një certifikatë të avancuar profesionale të prokurimit.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyrë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Data: 18.12.2017




Safet Hoxha – Kryetar i KRPP-së